

REPUBLIKA E ALBANIËS
MINISTRIA E FINANCËVE
DHE EKONOMISË



Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore

RAPORT

VITI 2018

Janar 2019

I. PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	II
HYRJE	III
QËLLIMI DHE METODOLOGJIA	IV
ARRITJET E FUNDIT NË DREJTIM TË PËRMIRËSIMIT TË METODIKËS INSPEKTUESE	V
RAPORTIME SIPAS DEPARTAMENTEVE	VI
PUBLIKIME DHE AKTIVITETE	VII
PROBLEMATIKAT E HASURA	VIII
KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	IX
OBJEKTIVAT PËR VITIN PASARDHËS.	X

II. PËRMBLEDHJE

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, është institucioni i ngarkuar për kontrollin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore rregulluese që mbulojnë fushën e punës. Si një faktor i rëndësishëm i tregut të punës, jep kontribut në rritjen e nivelit të zbatueshmërisë së Legjislacionit të Punës nga aktivitetet ekonomike në të gjithë vendin. Krijimi i këtij institucioni daton në vitin 1994 dhe Ligji nr.9634 datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës” (i ndryshuar), ka transpozuar Direktivën Kuadër nr 81 të ILO-s.

Detyrat e qarta të qeverisë shqiptare, dhënë në lidhje me procesin tejet të rëndësishëm, të transparencës, sjelljes, dhe partneritetit me grupet e interesit, përbëjnë shtyllën kryesore në ngritjen e mekanizmit kyç për administratën e ISHPSHSH-së, e cila e fokusuar në tre aspekte, respektivisht në atë: ligjor, institucional dhe sisteme informacioni, të bëjë të mundur zbatimin në praktikë të ligjeve, duke synuar përmirësimin e përputhshmërisë së kuadrit ligjor rregullator dhe në të njëjtën kohë të shërbejë, si një instrument shumë efektiv në uljen e abuzivitetit me kryerjen e detyrës nga inspektorët e punës.

Analiza bazohet në rezultatet e arritura gjatë vitit 2018, krahasimisht me vitin 2017, si dhe treguesit e vitit 2018, në dy periudha krahasimore konkretisht, periudha Janar – Prill 2018 me atë Maj – Dhjetor 2018. Arsyeja e këtij krahasimi lidhet me ndryshimin e këndvështrimit në aspektin drejtues të institucionit për periudhën e dytë të 2018-ës, referuar sa më sipër.

Ky raport sjell në mënyrë sintetike një përmbledhje të përgjithshme të të gjithë veprimtarisë së ISHPSHSH-së, gjatë vitit 2018 bazuar në strukturën organizative aktuale, analizën e gjetjeve dhe konstatimeve gjatë veprimtarisë inspektuese, problematikat e hasura, si dhe evidenton praktika dhe metodologjitë innovative të zhvilluara në këtë periudhë.

Çështjet e inspektimit mbeten po aq prioritare sa edhe formalizimi i ekonomisë. Me synimin e garantimit të zbatimit të rregullave të njëjta në treg, mbrojtjen e konkurrencës së ndershme, të trajtuara dhe në studimin e bërë nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve, përkon tërësisht me vizionin dhe frymën që ne kemi përçarur gjatë këtij viti, duke na fokusuar në përcaktime shumë të qarta të objektivave që do arrijmë në 2019.

III. HYRJE

“Asnjë progress ekonomik, asnjë prosperitet për të gjithë nuk mund të arrihet pa mbrojtjen dhe sigurinë në vendin e punë. Inspektori i punës është promotori i realizimit të këtij qëllimi modern me inspektimet e tij” ky është koncepti i Bashkimit Europian, mbi inspektimin e punës.

Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, duke u fokusuar për:

Fushën e inspektimit të punës në:

- ⇒ Forcimin e sistemit të inspektimit të punës
- ⇒ Reduktimin e punësimit informal
- ⇒ Përdorimin e masave efikase për të patur më shumë vende pune të sigurt dhe të shëndetshme.
- ⇒ Më shumë punëmarrës dhe punëdhënës të informuar dhe këshilluar për të drejtat dhe detyrimet që ju burojnë nga legjislacioni i punës.

Fushën e inspektimit të standarteve të shërbimeve shoqërore në:

- ⇒ Garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kategoritë e subjekteve të përkujdesit shoqëror.
- ⇒ Vlerësimin e standarteve për subjektet, që duhet të liçensohen.
- ⇒ Vlerësimi i nevojave sociale kryesore të komunitetit në nevojë për bashkëpunim me strukturat e pushtetit vendor.

synon, që përmes kontrolleve të vazhdueshme të sigurojë rritjen e performancës së aktiviteteve ekonomike në drejtim të respektimit të të drejtave të punëmarrësve për të patur një punë të denjë.

E gjithë sa më sipër, realizohet duke patur një bashkërendim të punës dhe zbatim të plotë të roleve përkatëse nga e gjithë struktura e ISHPSHSH-së. Në këtë kuadër veprimtaria inspektuese e realizuar nga trupa e terrenit e organizuar në 12 qarqe, kërkon një monitorim, koordinim dhe orientim të vazhdueshëm nga Drejtoria Qendrore e ISHPSHSH-së. Gjithashtu është e nevojshme që për çështje të caktuara të kemi një bashkëpunim me partnerët tanë, si në aspektin strategjik dhe politikbërës ashtu dhe në atë ligjzbatues.

IV. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA

ISHPSHSH-ja si institucion ekzekutiv duhet të garantojë që veprimtaria inspektuese e inspektorëve të punës do të jetë në frymën e ligjit dhe në koherencë të plotë me objektivat strategjike të tij: a) rritja e efektivitetit të inspektimeve të punës b) rritja e nivelit të transparencës për procesin e inspektimit, si dhe c) shmangjen e abuzimit me detyrën në shkelje të ligjit nga të dy aktorët e përfshirë në këtë proces, inspektorë pune dhe punëdhënës.

Metodologjia e përdorur në hartimin e këtij raporti, bazohet në katër shtylla metodike, konkretisht në; a) të dhënat statistikore të treguesve të inspektimit , b) identifikimi i problematikave nga analiza e gjetjeve c) Konsultimi me legjislacionin në raport me zbatimin në praktikë të tij, d) Zhvillimin e metodologjive, platformave inovative.

- a) Të dhënat statistikore të treguesve të inspektimit. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të inspektimit konkretisht ajo e:

Fushës së punës realizuar nga 12 Degët Rajonale. Këto të dhëna përfshijnë: (*)Numrin e inspektimeve të realizuar nga çdo inspektor pune (*) Llojit të inspekimit të kryer, (*) Sipas llojit të aktivitetit ekonomik, (*)Numrit të aksidenteve në punë, (*) Ankesave, (*) Informalitetit, (*) Punësim kategorish të veçantë punëmarrësish, (*) Shkeljeve të dispozitave ligjore, (*) sanksioneve të vendosura dhe ndjekjes së tyre.

Instrumentat e Fushës së shërbimeve shoqërore që përfshijnë: (*) Të dhëna nga data-base për kapacitetet e qendrave të përkujdesit (*) Pyetësor për menaxherët dhe drejtues të qendrave (*) Pyetësor për punonjësit social dhe (*) Intervistat me përfituesit.

- b) Identifikimi i problematikave nga analiza e gjetjeve duke parë krahasimisht trendin pozitiv dhe negativ të çështjeve specifike, që reflektojnë nga njëra anë nivelin e zbatimit të legjislacionit të punës nga punëdhënësit në aktivitetet ekonomike të tyre dhe nga ana tjetër ato të standarteve të shërbimeve shoqërore në qendrat e përkujdesjes sociale.
- c) Konsultimi me legjislacionin në raport me zbatimin në praktikë të tij, duke identifikuar çështjet apo situatë që nuk mbulohen shprehimisht nga ligji apo vetë situata dhe rrethanat e bëjnë të pazbatueshme në praktikë një dispozitë ligjore. Për të dyja konstatimet, evidentim të adresimit të problematikës/ave në autoritetin përgjegjës.
- d) Zhvillimin e metodologjive, platformave inovative. Duke evidentuar arsyet, qëllimin dhe çfarë synohet përmes zhvillimit të tyre.

V. ARRITJET E FUNDIT NË DREJTIM TË PËRMIRËSIMIT TË METODIKËS INSPEKTUESE

Si rezultat i presionit pozitiv në rritje, nga ana e Qeverisë Shqiptare që prej 2017 dhe në kuadër të një iniciative, për të progresuar me Reformën e Inspektoriateve në kuadër të reformës derregullatore, e cila ndihmon për sa i përket rolit dhe misionit të inspektoriateve, jo vetëm në drejtim të efektivitetit, por edhe transparencës dhe luftës kundër korupsionit, dhe nga ana tjetër rrit frymën e besimit të grupeve të interesit me Administratën Shtetërore.

ISHPSHSH-ja si inspektorat shtetëror, që funksionet inspektuese i bazon mbi Ligjin nr 10433/2011 “Për inspektimin në RSH” si dhe Ligjin organik nr. 9634 datë 30/10/2006 “Për inspektimin e punës” (i ndryshuar), gjatë vitit 2018 të gjithë inspektimet e kryera, pa asnjë përjashtim i ka kryer përmes sistemit unik “e-inspektimi”. Inspektimit online, përcjell në vetvete, nëpërmjet transparencës së inspektimit, besimin tek ky shërbim.

Në këtë kontekst, në institucionin tone, janë ndërmarë një sërë masash tejet transparente dhe inteligjente të cilat u japin mundësi përdorimi, grupeve të interesit (punëdhënës, punëmarrës/sindikata , inspektorë pune si dhe cilindo të interesuar). Masat i përkasin ngritjes së platformave inovative dhe përmirësimit të sistemeve, si dhe palaneve afat shkurtëra për përmirësim cilësor të situatës së treguesve të institucionit. Kështu :

Rikonceptimi i Faqes Zyrtare www.inspektoriatipunes@sl.gov.al ka bërë që faqja zyrtare e ISHPSHSH-së të kthehet në një platformë informuese dhe ndërvepruese e aksesueshme edhe në gjuhën angleze.

Deri tani është vizituar nga 4699 përdorues, nga të cilët, 59 % e tyre janë vizitorë të kthyer, pasi e kanë vizituar dhe më parë. Interesi i përdoruesve mbi ëëbin, ka pësuar një rritje të ndjeshme nga muaji në muaj për 6-mujorin e dytë të 2018, periudhë gjatë së cilës u bë funksionale kjo faqe e ristrukturuar. Çdo vizitor ka qëndruar mesatarisht më shumë se 3.5 minuta për të eksploruar, kohë kjo e mjaftueshme për të marrë informacion mbi aspekte të rëndësishme të publikuara, të cilët kanë shfaqur interes pothuajse për të gjithë kategoritë e të dhënave të faqes. Mund të veçohen, rubrikat kontakt me inspektorin, për të njohur detyrimet e përgjithshme të punëdhënësit, për të njohur bazën ligjore mbi të cilin mbështetet inspektimi.

Kjo tregon se punëdhënësi/punëmarrësi kërkon të informohet, duke krijuar kështu njohuri edhe mbi procedurat e inspektimit si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre. Grup-mosha e re (25 - 44 vjeç) përbëjnë 62% të vizitorëve, tregon edhe rolin e teknologjisë dhe inovacionit për të krijuar dialog me punëdhënësit/punëmarrësit e kësaj kategorie. Aspekt tjetër pozitiv është dhe gjeografia e vizitorëve, ku 82 % të vizitorëve janë nga Shqipëria, 13 % nga Kosova e pjesa tjetër nga shtete të tjera.

Ndryshimi total i saj, duke patur në qendër të vëmendjes punëmarrës e punëdhënës, dhe shërbimet ndaj tyre, krijon mundësi për aplikim online të:

⇒ Denoncimeve, Ankesave,

- ⇒ Aplikimeve për kërkesë për Leje Pune, për Autorizim për kryerje të punës jashtë kohës normale, Autorim për të punësuar të mitur,
- ⇒ Ankim kundrejt vendimit të inspektimit ,
- ⇒ si dhe informacione të tjera mbi inspektimit.

Tashmë raportet vjetore e progresive të punës të ISHPSHSH-së, dokumentacioni standart dhe ffishat e inspektimit që përdor inspektori i punës gjatë procesit të inspektimit janë të publikuara.

Në faqen zyrtare të ISHPSHSH-së tashmë është integruar dhe është e aksesueshme dhe Platforma “Matrica e Dënimeve”, e cila ka kërkuar shumë orë pune e përkushtimi nga ana e gjithë trupa inspektuese. Kjo platformë filloi të projektohet me qëllimin e sigurimit të transparencës së vendimarrjes së inspektorit të punës, pasi lehtësisht e konstatueshme ishte, që nuk përdorej i njëjti standart për të gjithë shkelësit e ligjit. Duke e konsideruar domosdoshmëri vendosjen e standarteve në punën tonë, para se të kërkojmë zbatimin e standarteve të punësimit nga biznesi, përmes saj synojmë të :

- ⇒ Ulim në maksimum abuzimin me detyrën nga inspektorët e punës, pasi procesi i vendimarrjes do të jetë krejt transparent.
- ⇒ Ndikojmë drejtpërsëdrejti në rritjen cilësore të inspektorëve të punës, sa i takon kapacitetin profesional të tyre.
- ⇒ Dhënien e mundësisë së vetëkorrigjimit punëdhënësve, të cilët do të testojnë veten e tyre se në cilin nivel të zbatimit të ligjit e gjejnë veten.
- ⇒ Mundësojmë trajtim të barabartë, sa i takon Masës së sanksionit për biznesin, në raport me reflektim të të njëjtave shkelje të dispozitave ligjore. Kjo do të thotë masë e njëjtë sanksioni për të njëjtën shkelje ligjore, në të njëjtat kushte.
- ⇒ Marrjen e informacioneve mbi inspektimet e kryera nga ISHPSHSH, në kohë dhe në përmbajtje, duke synuar në pasjen e një metodologjie të vlerësimit të riskut për çdo shkelje të konstatuar të legjislacionit të punës.
- ⇒ Tashmë ne mund të marim të dhëna dhe vlerësim mbi dispozitat ligjore të shkeluara më së shumti, me qëllim ndërtimin e planifikimeve të orientuara qartë për inspektimet.

Përmes planeve të masave afat shkurtëra është synuar rritja e efektivitetit të inspektimit të punës. Masa konkrete të ndërmarra, në këtë kuadër janë:

Orientim i qartë i inspektorëve të punës përmes një udhëzuesi, për Inspektimet Këshilluese, duke e konsideruar një etapë shumë të rëndësishme në marrëdhënien me biznesin takimin për herë të parë të inspektorit të punës me të.

Gjatë këtij viti, në kuadër të deregulimit angazhim ky i gjithë Qeverisë, edhe ISHPSHSH-ja ka futur konceptin e metodologjive të reja inspektuese. Kështu ka ndjekur e zbatuar me procedurë të përsheptuar inspektime me kërkesë të subjektit për këshillime, autorizime për punësim të miturish, për leje pune, autorizim të punës në orët jashtë kohës normale të punës.

Orientim i kryerjes së inspektimeve në zbatim të ligjit nr. 10433/2011 “Për inspektimin në RSH” sa i takon inspektimeve rastësore të kryera në kushtet e shkeljeve flagrante me iniciative të vetë inspektorëve. Kontrollat gjatë fundjavës na kanë rezultuar shumë efikase duke qënë se informaliteti konsumohet më së shumti në fundjavë.

Hartimi i regjistrit të subjekteve të inspektuara në vite nga ISHPSHSH-ja me tregues inspektimi dhe dispozita ligjore të shkelura, që shërben, si platformë e saktë, e integruar edhe në “ Matricën e dënimeve”, për procesin e planifikimit të inspektimeve, duke pasur tashmë orientim të qartë për sektorët, që paraqesin më shumë risk.

Kemi një rritje të bashkëpunimit institucional me Drejtoritë e Tatim Taksave dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, krahasuar me vitin 2017 , në drejtim të shkëmbimit të informacionit në kohë reale, sa u takon të dhënave të subjekteve dhe deklarimeve për punonjësit. Është bërë i mundur aksesimi në kohë reale i Listëpagesave të punëmarrësve të cilat deklarohen online nga subjektet në organet tatimore Formulari “E-sig 025”, i cili nga muaji gusht 2018, aksesohet nga inspektorët e punës, në çështjen e inspektimit për të cilën janë autorizuar.

Organizim me sukses i Fushatës së Ndërtimit në bashkëpunim me Zyrën Ndërkombëtare të Punës ILO në kuadër të Projektit PPÇS (Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale), i financuar nga Komisioni Europian me synimin, forcimin e inpektoriave të punës të Ballkanit Perëndimor, gjatë periudhës Maj-Qershor 2018. Trupa inspektuese ka kryer fushatën sensibilizuese e inspektuese në sektorin e ndërtimit¹.

Përfshirje cilësore sa u takon raportimeve të bëra nga ISHPSHSH-ja në Institucione Kombëtare dhe Ndërkombëtare, duke u bërë faktor në çështje sensitive si ajo e respektimit të të drejtave që burojnë nga ligjet e punës. Më konkretisht jemi pjesë e raportimeve në:

- 1- Kapitullin 19 “Politika Sociale dhe Punësimi” si pjesë e Planit Kombëtar për Integrimin Europian - i raportohet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- 2- TIP Report 2018 për “Trafikimin e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”, puna e fëmijëve dhe puna e detyruar i raportohet Ministrisë së Brendshme dhe DASH (Departamenti Amerikan i Shtetit), Ambasada Amerikane
- 3- Kapitulli 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”- i Raportohet Ministrisë së Drejtësisë
- 4- “Puna e fëmijëve dhe puna e detyruar”- Raportimi bëhet tek DOL (Department of Labour) Ambasada Amerikane.
- 5- MFE- Raportime për Konventat e ILO 77; 78; 81; 129 dhe 155
- 6- Raportime në Kuvendin e Shqipërisë për çështje specifike të kërkuara.

Me qëllim ngritjen e kapaciteteve të trupës inspektuese, kemi ngritur një ekip të brendshëm, i cili ka nisur trajnimet e inspektorëve, si në aspektet e komunikimit ashtu edhe të rritjes tyre profesionale. Sigurisht që kjo masë nuk është vetëm në planin afatshkurtër por dhe në atë

¹ **Aneksi Nr.2**, permban informacion të hollësishëm për zhvillimin e kësaj fushate.

afatgjatë, pasi ngritja kapaciteteve profesionale e trupës inspektuese dhe rritja e cilësisë së komunikimit të inspektorëve të punës, është thelbësore për të patur një proces inspektimi korrekt dhe cilësor.

Pavarësisht se vazhdon mosmiratimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe me të njëjtat burime njerëzore, DISSSHSH, vetëm në sajë të mbështetjes logjistike, arriti në vitin 2018 të realizojë 55 inspektime më shumë se një vit më parë.

Këto arritje të rënditura më lart, japin efekt të drejtpërdrejtë në luftën pa kompromis të informalitetit në punë të çdo forme të shfaqjes, përmirësimit të situatës së kushteve të punës dhe shëndetit në punë, planifikim subjektsh për inspektim mbi bazë risku, rritjes së “inteligjencës” së inspektorëve, evidentimin të fushave më të prekura në aspektin e përputhjes me kuadrin rregullator, si dhe vendosjen e standarteve të njëjta në proceset e inspektimit.

VI. PËRGJEGJËSI SPECIFIKE

Me qëllim orientimin e qartë të bashkëpunimit ndërinstitucional është caktuar një njësi në Drejtori Qëndrore të ISHPSHSH-së për koordinimin e të gjithë njoftimeve të Degëve Rajonale, në lidhje me subjektet pa liçensë të konstatuara. Pavarësisht faktit se inspektorët e punës nuk kanë të drejtë të zhvillojnë inspektim në një subjekt informal (të palicensuar), kanë detyrimin e njoftimit pranë Autoritetit përgjegjës për këtë konstatim. Kështu për vitin 2018, janë përcjellë në Drejtorinë e Hetimit Tatimor, praktika të plota për 190 subjekte që janë konstatuar të punojnë të parregjistruar në organet tatimore. Nga të dhënat na rezulton se qarku Kukës, Korçë, Elbasan janë qarqet që kanë raportuar më shumë subjekte informale. Pavarësisht faktit se kemi qënë shumë të qartë në adresimin e rasteve, nuk kemi përgjigje për formalizimin e këtyre subjekteve për të vijuar me procedurë inspektimi në lidhje me respektim të dispozitave ligjore të punës.

Përmes një orientimi të qartë të Degëve rajonale për të vijuar bashkëpunimin në nivel rajonal me DRT-të ka munguar bashkëpunimi nga këta të fundit, ku në shumicën e rasteve nuk kthejnë përgjigje apo edhe në ato pak që kthejnë shprehen për pamundësi të vënies në dispozicion të këtij informacioni degëve tona rajonale. Theksojmë se kjo kërkesë bazohet në pikën 3, të nenit 11 të Ligjit nr. 9436/2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetsore në RSH, ku shpehimisht thuhet”... *Këto deklaratat (deklarimet për të punësuarit) shërbejnë edhe për ISHPSHSH-në dhe i vihen në dispozicion këtij të fundit nga ana e administratës tatimore në rrugë elektronike...*”


Edhe bashkëpunimit me QKB-në nuk është në nivelin e duhur për të marrë informacionin e në kohë për listë subjektesh të reja, me të dhëna të subjekteve dhe ushtrimit të aktivitetit, pasi disponimi i këtij materiali na bën të orientojmë qartë inspektimet këshilluese në raport me subjektet e reja.

Bashkëpunimi me Inspektoratin Qëndror ka qënë i vazhdueshëm. Kemi të nevojshëm koordinim e inspektimeve në rastet e inspektimeve të përbashkëta për të vepruar në zbatim të parimit të dispozitës më të favorshme ligjore, që rregullon një situatë të caktuar dhe për të cilën kemi ende çështje për të diskutuar në këtë drejtim.

Për hetimin dhe trajtimin e rasteve të aksidenteve të ndodhura në rrugë apo në miniera apo të njoftuara me vonesë, ka funksionuar bashkëpunimi me Policinë , Prokurorinë, ISSH, ISHTI, ISHSH dhe AKSEM.

VII. RAPORTIMI SIPAS TREGUESVE TË PUNËS

Struktura e ISHPSHSH-së bazuar në Urdhërin nr. 1, datë 7.01.2014 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPSHSH-së” të ndryshuar, kishte 155 punonjës dhe me Urdhërin nr. 116, datë 31.07.2018 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr. 1, datë 7.01.2014 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së ISHPSHSH-së”, të ndryshuar”, aktualisht numri i punonjësve të strukturës është 154.



Treguesit e inspektimeve në Fushën e Punës

Nga të dhënat statistikore të treguesve të inspektimit, më poshtë jepen analiza e gjetjeve sipas specifikave duke ndërtuar analizën në rënditjen e logjikës në lidhje me ; (i)Të dhënat statistikore të treguesve të inspektimit, (ii)Identifikimi i problematikave nga analiza e gjetjeve, (iii)Konsultimi me legjislacionin në raport me zbatimin në praktikë të tij, (iiii)Zhvillimin e metodologjive, platformave innovative, duke u bazuar në numrin e inspektimeve të realizuara nga çdo inspektor pune .

Mbështetur në dy ligjet bazë të inspektimit, Ligji Nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit rr. 9634, datë 30.10.2006 “Për Inspektimin e Punës”, gjatë Vitit 2018, Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ka kryer gjithsej 12297 inspektime në subjekte Private dhe Shtetërore dhe ka inspektuar e këshilluar 291 244 punëmarrës.

Nga një analizë e punës inspektuese, numri i subjekteve të inspektuara për inspektor pune gjatë vitit 2018, e kemi analizuar në dy periudha kohore, ashtu siç cituam dhe në Kapitullin e Metodologjisë së përdorur.

Në pjesën e parë të vitit, e konkretisht në periudhën Janar-Prill 2018, mesatarja e inspektimeve realizuar nga trupa inspektuese rezultonte, 27 subjekte për inspektor. Për këtë periudhë kohore, rezulton se numri i inspektimeve të kryera ishte 3 herë më e ulët se krahasimisht me një vit më pare.

Për periudhën Maj-Dhjetor 2018, ritmi i punës në drejtim të cilësisë së inspektimit e me rezultate direkte në zbatueshmërinë e dispozitave ligjore të legjislacionit të punës, nga subjektet private e shtetërore, arrin në 104 subjekte për inspektor, ose 3.9 herë më e lartë se në periudhën e parë Janar-Maj 2018.

Zhvillimi i metodologjive të reja mbi vlerësimin e planifikimit të inspektimeve mbi bazë:

- ⇒ risku për shkelje flagrante të legjislacionit të punës që lidhen me informalitet dhe siguri e shëndet në punë.
- ⇒ zhvillimin e aktivitete të reja dhe jo atyre që ende nuk kanë marrë shërbimin e inspektimit të punës, etj

rezultoi në rritjen e efektivitetit të inspektimeve, duke çuar inspektimin në subjekte me numër të konsiderueshëm punëmarrësish, në ato me shkelje flagrante e mbartës të informalitetit të tregut të punës, në vendosjen e marrëdhënieve të reja me biznesin duke planifikuar inspektime këshilluese, e me njoftim për subjektet që nuk ishin inspektuar më parë nga inspektorët e punës.

Shifrat e krahasuara me një vit më parë janë në trend pozitiv. Pavarësisht këtij fakti, objektivat e institucionit duke patur vëmendje të shtuar për rritjen e eficensës së inspektimit, kjo bazuar në mirëorjentimin e planifikimit të inspektimeve, kanë patur qëllim jo selektivitetin në përzgjedhje, por fokusimin në zgjidhjen e problematikave të tregut të punës, këshillues duke ndjekur të gjithë etapat që parashikon ligji para vendosjes së një dënimi administrativ.

Gërshetimi i historikut të inspektimeve me arsyet e inspektimeve dhe shkeljet e dispozitave ligjore të konstatuara më parë, me subjektet aktive të QKB nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit ndërinstytucional, janë objektivi kryesor i yni që tashmë ka filluar të vihet në zbatim.

Kjo do të mundësojë synimet tona në ngritjen e nivelit të inspektimit dhe profesionalizmit në të tjera standarte.

Gjatë vitit 2018, jo të gjithë degët kanë patur të njëjtin ritëm pune, sa i takon numrit të inspektimeve të realizuara. Të dhënat e paraqitura më poshtë tregojnë numrin e subjekteve e vendeve të punës të inspektuara në 12 rajonet, me një mesatare për inspektor pune, për vitin 2018, në 131 për subjekte dhe rreth 300 për vende pune.

Krahasimisht me një vit më parë në terma absolute treguesi i numrit të inspektimeve është rritur me 4 mijë subjekte dhe 100 mijë vende pune.

80% e inspektimeve të kryera gjatë vitit 2018, janë rezultat i punës intensive realizuar në periudhën maj - dhjetor 2018.

Rritje e mesatares së vendeve të punës inspektuar e këshilluar, tregon, vëmendje të shtuar ndaj subjekteve e punëmarrësve, duke qënë më pranë në këshillimin e zbatimit të ligjit, si dhe në ndëshkimet e abuzuesve me të.

Tabela e mëposhtme pasqyron të dhënat krahasuese periudhave të sipërcituara.

	Private dhe Shtetërore			Vetëm Private		
	Inspektime Total (P+Sh)	Nr i Punëmarrësve (P+Sh)	Mesatare e vendeve të punës për subjekt	Inspektim e Total (Private)	Nr i Punëmarrësve	Mesatare e vendeve të punës për subjekt
Viti 2017	7958	182154	22.9	7923	176744	22.3
Viti 2018	12297	291244	23.7	12222	272296	22.3
Janar-Prill 2018	2465	79598	32.3	2443	76321	31.2
Maj-Dhjetor 2018	9832	211646	21.5	9779	195975	20
Periudha maj-dhjetor ne % kundrejt totalit	80%	73%		80%	72%	

LLOJIT TË INSPEKTIMIT TË KRYER²

Inspektimet e realizuara në vitin 2018 në masën 92.3%, janë realizuar mbi bazën e programimit sipas ligjit nr 10433/2011 “Për inspektimin në RSH”.

Këto programime janë kryer mbi bazë të arsyeve të mëposhtme:

² **Aneksi Nr 1:** Të dhëna të detajuara, mbi inspektimet e kryera gjatë vitit 2018, edhe sipas 12 Rajoneve.

- ⇒ Subjekte me detyra e shkelje ligjore për t'u korigjuar e të lëna në inspektimet e mëparshme.
- ⇒ Inspektime realizuar në turne të dyta e të treta, apo të festave zyrtare, ditët e pushimeve javore, arsye këto mbi evidentimin e zbatueshmërisë së marrëdhënieve të punës e jo vetëm, të punëmarrësve e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në këto periudha kohore, e ku marrëdhënia e punës merr një këndvështrim të veçantë sipas Kodit të Punës.
- ⇒ Inspektime në kuadër të luftës kundër informalitetit, punësimit të të miturve, apo respektimit të kohës së punës e pagesave për orët shtesë në periudhën e sezonit turistik.
- ⇒ Inspektime në kuadër të bashkëpunimit me institucione të tjera. Konkretisht gjatë këtij viti, në kuadër të bashkëpunimit me Zyrën Ndërkombëtare të Punës (ILO), kanë qënë inspektimet në aktivitetet ndërtuese.
- ⇒ Në inspektime për “e-shërbime”, e konkretisht të inspektimeve pas kërkesës së subjekteve për punësim të miturish, autorizim për orët shtesë, apo leje pune për ushtrim aktiviteti.

Ndryshe nga një vit më parë, me një vëmendje të shtuar, këtë vit janë inspektimet e iniciuara nga vetë inspektorët për shkelje flagrante të legjislacionit të punës e ku përqëndrimi i tyre është në periudhën Maj-Dhjetor duke përbërë 97.5% të inspektimeve rastësore të kryera gjatë gjithë vitit.

Theksojmë se, nga inspektimet e realizuara jashtë programimi, 49.5% të tyre e zënë inspektimet për shkak ankese, 17.2% inspektimet për shkak aksidenti në punë dhe 33.3% e zënë inspektimet rastësore.

Gjatë këtij viti edhe numri i inspektimeve për shkak ankese është i koniderueshëm, e ku 72.4% e inspektimeve për shkak ankese, janë realizuar në periudhën Maj-Dhjetor 2018.

Ndërkohë krahasimisht me një vit më parë, kemi numër të shtuar në 31 herë më shumë të rasteve të inspektimeve për për indicje të shkeljeve flagrante të ligjit, si dhe gati 2 herë më shumë të inspektimeve për shkak ankese.

Inspektimet jashtë programi, janë më së shumti inspektime me gjetje të shkeljeve të dispozitave ligjore e ku inspektimi mer kuptim me ndërhyrjet ligjore të inspektori të punës. Këtë e tregojnë dhe treguesit e mëposhtëm ku në 17% të rasteve të inspektimeve të programuara janë inspektime ku për shkak të gjetjeve, ka qënë e nevojshme ndërhyrja me dënime administrative.

Më të ndjeshëm në ndërhyrjet e inspektorëve të punës janë inspektimet e kryera për indicje të shkeljeve flagrante, ku në çdo inspektim të tillë ndërhyrjet ishin në “pezullim të pjesshëm” por jo vetëm, deri në realizimin e detyrave konkrete, për rregullimin e situatës.

Bazuar nga kjo analizë, në periudhën Maj-Dhjetor 2018, në të gjitha rajonet, me vëmendje të shtuar, për rastet e shkeljeve flagrante kryesisht të informalitetit e tregojnë edhe treguesit ku 95.6% e zbatueshmërisë së informalitetit në punë, është realizuar në këtë periudhë.

	Subjekte te inspektuara			Subjekte me denime administrative (paralajmerim +gjoba+pezullim)			Kontribues të munguar në skemën e sigurimeve, evidentuar gjatë procesit të inspektimit			Subjekte me dënime administrative (në %)
Lloji i inspektimit	Viti 2018	Maj-Dhjetor 2018	% e të dhënave maj-dhjetor 2018 kundrejt totalit (inspektime)	Viti 2018	Maj-Dhjetor 2018	% e të dhënave maj-dhjetor 2018 kundrejt totalit (dënime administrative)	Viti 2018	Maj-Dhjetor 2018	% e periudhes maj-dhjetor 2018 kundrejt totalit vjetor 2018	
Inspektime të programuara	11354	9080	80%	1958	1628	83%	978	928	95%	17%
Inspektime për shkak aksidenti në punë	162	108	67%	114	77	68%	21	3	14%	70%
Inspektime për shkak ankese	467	338	72%	173	139	80%	55	53	96%	37%
Inspektime rastësore (shkelje flagrante evidente)	314	306	97%	323	320	99%	526	526	100%	103%
Total Inspektime	12297	9832	80%	2568	2164	84%	1580	1510	96%	21%
Në total 20.9% e inspektimeve janë inspektime me dënime administrative										
Në total 89.2% e inspektimeve janë inspektime me shkelje të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës										

Duke llogaritur një mesatare mujore pune për dy periudha kohore të vitit 2018 konkluzionet janë:

- Ritmi i punës për periudhën 8 mujore maj-dhjetor 2018 në mesatare mujore të treguesve është:
- “mesatare e inspektimeve mujore” 2 herë më shumë se në 4 mujorin e parë të vitit,
- “mesatare e masa administrative mujore për shkelje të legjislacioni të punës”, 2.7 herë më shumë se në 4 mujorin e parë të vitit, ,
- “mesatare mujore e zbulueshmërisë së informalitetit të tregut të punës” 10.7 herë më shumë se në 4 mujorin e parë të vitit.

LLOJIT TË AKTIVITETIT EKONOMIK


Nga të dhënat e inspektimeve të subjekteve ekonomike (private e shtetërore) raportuar nga degët rajonale të ISHPSHSH-së, në 12 qarqet e vendit, kemi:

Sipas llojit të aktiviteteve ekonomike të inspektuara, numri më i lartë i inspektimeve të kryera, edhe për vetë natyrën e aktiviteteve në vend (të dhëna zyrtare të INSTAT) është ai i aktiviteve

tregtare, Hotel-Bar-Restorante, që zënë 47.1% të inspektimeve të kryera në vit. Ndërkohë inspektimet në aktivitetet prodhuese zënë 20.6% të totalit të inspektimeve, aktivitetet e ndërtimit zënë 8.5%, aktivitete nën ndarjen “Të tjera” 17.9%. Konkretisht sipas llojit të aktivitetit ekonomik në shifër janë të dhënat e 2018-s.

• Bujqësi, pyje, peshkim	203
• Miniera karriera	175
• Ndërmarrje Prodhuese	2539
• Elektricitet, gaz, ujë	66
• Tregti, hotel-bar-restorante	5789
• Ndërtim	1047
• Transport, magazinim, telekomunikacion	181
• Finance, shërbime të sigurimeve	101
• Aktivitete të tjera	2196

Inspektime në aktivitetet ekonomike të licensuara, sipas llojit të aktivitetit



Sa i takon llojit të aktivitetit “Ndërtim” ky i fundit, përsos subjekteve të kontrolluara gjatë vitit si objekt i Degës Rajonale kuadër të bashkëpunimit me Zyrën Ndërkombëtare të Punës, bazuar në Projektin PPCS (Platforma e Punësimit dhe Çështjeve Sociale) i financuar nga Komisioni Europian me komponent që synon forcimin e inpektorateve të punës së Ballkanit Perëndimor, gjatë periudhës Maj-Qershor 2018, trupa inspektuese ka kryer fushatë sensibilizuese e inspektuese në sektorin e ndërtimi.

Objektivat e kësaj fushate ishin, rritja e ndërgjegjësimit për rreziqet ekzistuese në ndërtim, promovimi i praktikave të mira kundrejt rreziqeve specifike të rënies nga lartësitë dhe përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale në kompanitë e ndërtimit duke kontribuar në

zvogëlimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, si dhe promovimi i bashkëpunimit ndërmjet inspektoriatëve të ndryshëm kombëtarë, shkëmbimin e informacionit, praktikave të mira, metodologjive të inspektimit dhe trajnimit, duke përfshirë mundësinë e organizimit të vizitave nga ekipet e përbashkëta të bashkëpunimit.

Gjatë kësaj fushate u përdorën edhe Postera dhe fletëpalosje për punën e padeklaruar, broshura mbi rreziqet dhe praktikën e sigurta në ndërtim, në lidhje me rëniet nga lartësitë dhe përdorimin e MPM (Mjeteve Personale Mbrojtëse).

ISHPSHSH, është angazhuar në këtë fushatë, në rajonet Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër, Vlorë, dhe Korçë me një staf prej 65 inspektore pune të këtyre degëve rajonale.

Trupa inspektuese e angazhuar në këto inspektime ka realizuar 480 inspektime, verifikime,

Në ndihmë të inspektimit, të këtyre subjekteve, për një panoramë të situatës së sigurisë dhe shëndetit në punë, me bashkëpunimin e ngushtë me Zyrën Ndërkombëtare të ILO-s dhe përfaqësuesve të tyre në Shqipëri, është bërë e mundur që krahas dokumenteve standarte inspektuese, inspektimi të pasqyrohet dhe me dokumentin në formë pyetësori “Aneksi 1”.

Gjatë muajve Qershor - Korrik – Gusht - Shtator 2018, ISHPSHSH, ka kontrolluar gjithsej 850 subjekte me aktivitet të shtuar në sezonin e verës, me total 9069 punëmarrës të evidentuar në këtë periudhë. (mesatarisht 10.7 punëmarrës për subjekt), për evidentimin dhe kontrollin e subjekteve, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sezonin turistik.

Risi në inspektimet e kësaj periudhe ka qënë dhe evidentimi i subjekteve me detyrim ligjor për punësim të rojeve të plazhit. Në total janë konstatuar, 16 roje plazhi me instruktimin e nevojshëm teknik. Ndër parregullsitë e vëna re në lidhje me rojet e plazhit ishte puna e kryer mbi kohën normale javore të punës, e ndërkohë pagesa e tyre në 73% të konstatimeve ishte paga minimale.

Gjatë muajit qershor 2018 në kuadër të raportimit në Kuvendin e Shqipërisë, janë inspektuar **88 subjekte mediatike private e shtetërore**, me 3004 punëmarrës të evidentuar ose mesatarisht 34 punëmarrës për subjekt.

AKSIDENTET NË PUNË


Aksidente në punë të hetuara gjatë vitit 2018 nga ISHPSHSH, sipas llojit të aktivitetit rezultojnë:

Viti 2018	Subjekte të inspektuara për shkak aksidenti në punë	Punëmarrës të aksidentuar	Punëmarrës të aksidentuar, me vdekje
<i>Bujqësi, pyje ,peshkim</i>	2	2	-
<i>Miniera, karriera</i>	35	45	6
<i>Ndërmarrje prodhuese</i>	40	50	4
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	13	17	3
<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	12	12	4

<i>Ndërtim</i>	24	26	5
<i>Transport, telekomunikacion</i>	2	2	-
<i>Finance, shërbime të sigurimeve</i>	1	1	-
<i>Aktivitete të tjera</i>	33	40	5
<i>Total</i>	162	195	27

Sa i takon inspektimeve për aksident në punë rezultojnë se sipas degëve rajonale, numri më i madh i inspektimeve për rast aksidenti në punë dhe i punëmarrësve të aksidentuar është në degën rajonale Dibër (në aktivitete minierare).

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik numri më i madh i rasteve të hetimit të aksidenteve në punë, rezulton në ndërmarrjet prodhuese e që zënë 25% të totalit të inspektimeve për aksident e e 26% të totalit të punëmarrësve të aksidentuar. Grafiku I mëposhtëm reflekton shpërndarjen në përqindje.



Krahasimisht me një vit më parë, rezulton rritje e numrit të aksidenteve në punë dhe përkatësisht edhe të numrit të punëmarrësve të aksidentuar. Aksidentet me pasojë vdekjen Ka marrë vëmendje, situata e çështjeve të sigurisë dhe të shëndetit në punë nga vetë subjektet dhe rritjen e kësaj shifre e lidhim me ndërgjegjësim për deklarim të aksidenteve të punë nga punëdhënësi, për zbatim të ligjit dhe të pasojave të mosdeklarimit të aksidenteve, si dhe informacioni i shtuar së bashku me krijimin e lehtësirave për këtë raportim. Vetëm nga faqja zyrtare, nga muaji Korrik 2018 janë deklaruar 11 raste aksidentesh në punë, duke mundësuar deklarim të tyre në çdo ditë dhe orë të javës, përfshirë ditën e pushimit javor apo ditët e festave zyrtare.

Përveç aksidenteve të njoftuara nga vetë punëdhënësit ashtu siç ligji e parasheh, këtë vit kemi të regjistruara dhe aksidente të ardhura përmes burimesh të tjera e konkretisht:

- ⇒ 5 aksidente në punë të ardhura nga prokuroria, për të cilat e kemi konsideruar indicie të mjaftueshme për të filluar një procedurë inspektimi jashtë programit, edhe pse nga data e ngjarjes kishte kaluar kohë.
- ⇒ 5 aksidente në punë nga informacionet e trasmetuara në media, për të cilat kemi verifikuar menjëherë rastin duke nisur procedurë inspektimi.
- ⇒ 1 rast ankese për çështje aksidenti në punë ardhur nga Platforma e Bashkëqeverisjes.

24 raste i përkasin lëndimeve të lehta në punë apo **“gati aksidenteve”**, të cilat edhe pse hetohen nga vetë punëdhënësi (sipas parashikimit ligjor më pak se 3 ditë paaftësi në punë) janë raportuar, duke theksuar edhe një herë rolin e madh të informimit të punëdhënësve. Në këto raste sigurisht inspektorët e punës i kanë ndjekur, për tu përkthyer në masa konkrete me qëllim parandalimin në të ardhmen.

Aksidentet e ndodhura në rrugë (nga puna për në shtëpi apo anasjelltas, apo gjatë kryerjes së punës sipas përshkrimit të saj), të cilat klasifikohen si aksidente në punë, këtë vit shënojnë një rritje të konsiderueshme me 28 punëmarrës të aksidentuar më shumë dhe 3 punëmarrës më shumë me humbje të jetës se një vit më parë.

Nga 162 raste të aksidenteve të ndodhura, aksidentet masive (ku të paktën dy apo më shumë punëmarrës dëmtohen në të njëjtën kohë dhe për shkak të së njëjtës arsye), përbëjnë 4.8 % të aksidenteve , të cilat kryesisht u përkasin aksidenteve rrugore.

Numri i lartë i aksidenteve të ndodhura në aktivitetin minerar, me 10 punëmarrës të aksidentuar më shumë se një vit më parë, pavarësisht faktit se minierat klasifikohen si aktivitet me risk të lartë në drejtim të aksidenteve, dhe rregullimit me ligj specifik të këtij sektori për çështjet e sigurisë në punë, nga të gjithë autoritet ligjzbatuese ka nevojë të shtuar për kontrole të vazhdueshme.

Nuk kemi të raportuara raste të aksidentuar fëmijë, gra shtatëzana/ gra me fëmijë në gji apo persona me aftësi të kufizuar, grupe këto që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga legjislacioni i punës.

Aksidentet e përsërituar në të njëjtin subjekt më shumë se një herë, për vitin 2018 kanë ndodhur në 12 subjekte dhe që përbëjnë 7.4 % të rasteve të aksidenteve të ndodhura. Aktivitetet ku kanë ndodhur janë kryesisht aktivitete të klasifikuara me risk të lartë si miniera, elektricitet, industri e rëndë, ndërtim dhe aktivitete të tjera në të cilat janë rastet e aksidenteve në rrugë.

Ka funksionuar bashkëpunimi për trajtimin e rasteve të aksidenteve në punë, për shkak dhe të specifikave që i shoqërojnë si në kuadër ndërintitucional, përmëndim këtu, Policinë, Prokurorinë, ISHT-in, AKSEM-in, si dhe brenda institucionit niveli rajonal me atë qëndror. Përmes udhëzimeve të vazhdueshme dhe monitorimit të punës, rast pas rasti kemi synuar të rrisim cilësinë e hetimit të ngjarjeve (mekanizmin shkak – pasojë) dhe trajtimit procedural të

praktikave të aksidenteve, pasi ngjarje të tilla identifikojnë difektet e sistemit të sigurisë në punë brenda subjektit, ku dhe kërkohet analizë e thelluar për masat që duhet të ndërmerren. Pjesë e orientimit të punës së Drejtorisë Qëndrore ka qënë prioriteti i dhënë riinspektimeve të subjekteve , të cilat kanë në historik të tyre aksidente në punë, me qëllim verifikimin e realizimit të detyrave të lëna, për parandalimin e rasteve të ngjashme në të ardhmen.

Masat administrative gjobë apo paralajmërim në subjektet e inspektuara për rast aksidenti, janë 5% më shumë krahasimisht me një vit më parë.

Gjithashtu, në kuadër të dëmtimeve që vijnë nga puna, sa u takon sëmundjeve profesionale të cilat shfaqen në kohë më të vonshme, numri i deklaruar i punëmarrësve me sëmundje profesionale rezulton në ulje. Për të përcaktuar këtë trend, në fakt i referohemi deklarimeve të bëra nga vetë mjekët e ndërmarrjeve, të cilat mbeten në statusin e rasteve të dyshuara, por jo të vërtetuara nga mjeku specialist i sëmundjeve profesionale, ashtu sic e parashikon ligji. Mungesa e kabineteve të sëmundjeve profesionale rajonale dhe qendrore , bën që në raport me këtë tregues të mos kemi statistika të qarta për raportim.

ANKESAT E ADRESUARA DHE INSPEKTIMET PËR SHKAK ANKESË

Gjatë vitit 2018 janë rregjistruar gjithsej 620 ankesa dhe kërkesa, të cilat në varësi të objektit të ankimit/kërkesës janë trajtuar me inspektim apo verifikim rast pas rasti.

Sqarojmë se në rregjistrin e ankesave është rregjistruar çdo ankim/kërkesë e ardhur pranë ISHPSHSH-së .Ankesat janë adresuar nga disa drejtime përkatësisht;

- ⇒ Nga Platforma e Bashkëqeverisjes janë adresuar pranë ISHPSHSH-së 113 ankesa, të cilat përbëjnë 18.2 % e ankesave të ardhura gjithsej.
- ⇒ Nga Faqja Zyrtare e ISHPSHSH-së nga adresat Info@sl.gov.al dhe Ankesa@sl.gov.al , janë adresuar 146 ankesa, të cilat përbëjnë 23.5 % të ankesave të rregjistruara dhe të trajtuara.
- ⇒ Pjesa tjetër, janë paraqitur dhe janë rregjistruar në protokollin e institucionit sin ë degë rajonale ashtu dhe në atë qendrore.
- ⇒ 467 subjekte ose 75.3 % e tyre janë trajtuar me proces të mirëfilltë inspektimi , kurse diferenca janë trajtuar me informacione pas verifikimeve të bëra ose ankesa të cilat na figurojnë të ridrejtuar pranë nesh, me të njëjtin objekt animimi, si më parë.

Sipas arsyes së paraqitjes së ankesave nga të dhënat e ankesave rezultojnë 15 ankesa të adresuara për mosnjohim aksidenti të ndodhur në punë, të cilat kanë ndikuar dhe në numrin e lartë të aksidenteve në punë që raportohen në 2018 nga ISHPSHSH-ja.

Numrin më të madh të ankesave e gjejmë në llojin e aktiviteteve Tregti (H-B-R) ku janë rregjistruar 109 ankesa dhe në grupin e aktiviteteve “Te tjera” janë rregjistruar 256 ankesa të cilat i gjejmë në nënaktivitetet SHPSF, Media, Call Center dhe sidomos Ndërmarrje Shtetërore. Ankesat që adresohen për subjekte shtetërore dhe janë të përfshira në nëngrupin “Të tjera”, këtë vit janë rregjistruar 4.6 herë më shumë se një vit më parë. 67.4% e ankesave të ardhura në

drejtim të subjekteve shtetërore janë zgjidhur plotësisht/pjesërisht, në favor të pretendimeve të punëmarrësve. Ky është një tregues flet qartë, për faktorizimin e institucionit tonë, në të cilin marrin zgjidhjen edhe çështje të punësimimit të punëmarrësve shtetëror.

Sipas zgjidhjes së ankesave rezultojnë se :


- ⇒ 269 ankesa kanë marrë zgjidhje në favor të punëmarrësve
- ⇒ 138 ankesa janë zgjidhur pjesërisht në favor të punëmarrësve
- ⇒ 213 nuk janë zgjidhur.

Faktorët që kanë ndikuar në moszgjidhjen e ankesave, lidhen me arsye të mosgjatjes të drejta të pretendimeve të ankuesve, zgjidhja e tyre kalon kompetencën lëndore dhe juridike të inspektorit të punë si dhe raste kur ankimimet nuk kanë elementët e domosdoshëm për të identifikuar subjektin ndaj të cilit adresohet ankesa.

Rezulton numër shumë i ulët i ankesave për kushte pune të pasigurta me vetëm 11 ankesa të ardhura për këtë shkak, nuk reflekton situatën e terrenit.

INFORMALITETI

	Inspektime të kryera	Vende pune të inspektuara	Informal të evidentuar	Të siguruar gjatë procesit	Masa Urgjente/Peçullime	Gjoha
<i>Viti 2018</i>	12297	291244	1580	1515	855	175
<i>Viti 2017</i>	7958	182154	607	576	221	80
<i>Krahasime (më shumë në 2018)</i>	4339	109090	973	939	634	95




Punësimi informal (subjekte private të inspektuara):

Po të hedhim një vështrim në të dhënat ndër vite, që publikohen në raportet e ISHPSHSH-së konstatohen lehtësisht, të dhënat mbi punën në të zezë apo punësimin e padeklaruar. Të dhënat i përkasin kategorisë së punëmarrësve informal të konstatuar të padeklaruar në subjekte formale apo të licensuara dhe aktivitete që zhvillohen krejtësisht në të zezë apo të palicensuara. Në subjektet e licensuara konstatimi i punësimit të punonjësve të padeklaruar është i mundur të formalizohet përmes masave konkrete ligjore që mer inspektori i punës, brenda procesit të inspektimit. Në rastet e subjekteve që konstatohen të punojnë krejtësisht në të zezë, në kushtet kur ligjërisht inspektorati i punës nuk ka autoritet të ndërhyjë, e adreson pranë Organet e Administratës Tatimore për të vijuar me trajtimin e rastit/rasteve. Formalizimi i marrëdhënies së punësimit të punonjësve që konstatohen të punojnë në të tilla kushte kërkon shumë më tepër kohë dhe varet nga bashkërendimi i punës mes dy administratave respektive.

Gjatë inspektimeve të aktiviteteve private në vitin 2018 janë evidentuar 1580 punëmarrës informal ku gjatë procesit të inspektimit janë siguruar 1515 prej tyre, nëpërmjet masës “pezullim” deri në sigurimin e tyre. Sipas llojit të inspektimit punëmarrësit informal kanë rezultuar:

Informaliteti i evidentuar, (i dhënë në përqindjen), sipas llojit të inspektimit të kryer.

	Punëmarrës Informal të evidentuar	Në % kundrejt totalit të Informalëve të evidentuar
Në planifikime mujore	661	41.8%
Në riinspektime	20	1.3%
Në inspektimet të realizuara në punën në turn të dytë, të tretë, ditët e pushimit javor e ditët e festave, kryesisht përmes inspektimeve rastësore.	592	37.5%
Në planifikime tematike të tjera (periudhë sezoni turistik, ndërtimi në bashkëpunim me ILO)	231	14.6%
Inspektime për Aksident	21	1.3%
Inspektime për Ankese	55	3.5%
Total	1580	




Kështu në 41.8% të rasteve të punëmarrësve informal të evidentuar, janë raste në inspektimet e realizuara si planifikime mujore falë një orjentimi të mirë të inspektimeve dhe 37.5% janë në inspektimet e realizuara në turne, ditët e pushimit javor apo ditët e festave zyrtare falë dhe indicieve për informalitet në tregun e punës. Në shifrën 592 janë përllogaritur inspektimet e realizuara kryesisht në ditët e pushimit javor e të iniciuara si inspektime jashtë planifikimi për indicie të shkeljes flagrante të “Informalitetit në Punë”

Numri më i madh i punëmarrësve informal të evidentuar rezulton në Tiranë, për shkak se ky rajon ka dhe numrin më të madh të inspektorëve dhe aktiviteteve të kontrolluara.

Të shprehura në përqindje kundrejt numrit total të punëmarrësve të evidentuar gjatë inspektimeve për çdo rajon, rezulton se informalitet më të lartë e mbartin degët; Kukës Elbasan, Shkodër, Vlorë. Ky vlerësim në fakt nuk flet se ky tregues reflektohet vetëm në këto qarqe, pasi informaliteti ka afërsisht të njëjtin trend shpërndarje në të gjithë territorin, por tregon mosvëmëndje të shtuar në raport me planifikimin mbi bazë risku për këtë tregues nga degët e tjera.

Ky vlerësim besoj i mbetet një të ardhme ku me historikun e inspektimeve të integruara edhe në matricë, mund të shprehemi si për një planifikim të saktë të inspektimit atje ku ka më shumë gjasa të ketë informalitet ashtu dhe të vlerësimit të punës së mëparshme inspektuese, për përsëritje të këtij fenomeni në subjekte të inspektuara edhe më parë.


Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet në përqindje informaliteti i konstatuar sipas rajoneve.



Të analizuara sipas llojit të aktivitetit ekonomik, nga inspektimet e kryera rezulton se përqindjen më të madhe të punësimit informal të evidentuar në raport me totalin e tyre e gjejmë kryesisht ne aktivitetet tregti (42.2 %), Ndërmarrje prodhuese (17.3 %), Ndërtim (16.6 %) . Ndërkohë që grafiku i mëposhtëm pasqyron detajet për të gjithë aktivitetet ekonomike të kontrolluara nga inspektorët e punës.

Viti 2018	Subjekte të inspektuara	Punëmarrës të evidentuar	Punëmarrës Informal të evidentuar	U siguruan gjatë procesit të inspektimit
<i>Bujqësi, pyje ,peshkim</i>	203	1095	74	68
<i>Miniera, karriera</i>	175	10582	74	74
<i>Ndërmarrje prodhuese</i>	2534	107563	274	268
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	51	2015	0	0
<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	5788	46118	667	624
<i>Ndërtim</i>	1047	22970	262	261
<i>Transport, telekomunikacion</i>	179	3872	24	24
<i>Finance, shërbime të sigurimeve</i>	101	3072	10	10
<i>Aktivitete të tjera</i>	2144	75009	195	186
<i>Total</i>	12222	272296	1580	1515

PUNËSIMI INFORMAL



Mosaksesi në kohë reale nga inspektorët e punës në të dhënat që ka formulari I deklarimit “E-Sig 027”, për të punësuarit rishtazi dhe të larguarit nga puna, nuk na mundëson të ezaurojmë procesin e evidentimit në kohë reale të fenomenit. Ky në fakt është një element I cili ul ndjeshëm cilësinë e punës së inspektorit të punës dhe kredibilitetin e këtij të fundit në raport me biznesin të cilit është i detyruar t’ia kërkojë këtë informacion.

Sa u takon të dhënave pjesë e raporteve të treguesve të inspektimit publikuar në vite, ka një mungesë të indikatorëve të saktë që reflektojnë informalitetin gri. Ka një përpjekje për të analizuar tregues, si numri i punëmarrësve që sigurohen mbi pagë minimale apo numri i të punësuarve që janë konstatuar të punojnë pa një marrëveshje me shkrim (kontratë pune), me qëllim daljen në konkluzion të mosdeklarimit të pagës reale të punëmarrësve apo mosrespektim i shtesave në pagë për punë të kryer në orë shtesë, ditë pushimi javor, punë e kryer ne turne të dyta e të treta, në ditë të festave zyrtare etj. si elementë të kontratës së punës. Sigurisht që në këtë drejtim e kemi parë shumë të domosdoshme përcaktimin e qartë të indikatorëve të matjes së këtij informaliteti për të shërbyer, si bazë analize për planifikim/orientim më të qartë në ato aktivitete, sektorë apo zona gjeografike që e mbartin më së shumti këtë fenomen.

PUNËSIMI I KATEGORIVE TË VEÇANTË PUNËMARRËSISH,

Në lidhje me punëmarrësit e evidentuar në punë rezulton se:

48.4% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrëse femra

1.3% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës që punojnë pa kontrata individuale pune.

26.2% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të siguruar në bazë të pagës minimale.

0.71% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës të huaj.

0.1% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës me aftësi të kufizuar.

0.1% e punëmarrësve të evidentuar janë punëmarrës nën 18 vjeç.

0.54% e punëmarrësve të evidentuar ishin punëmarrës të pasiguruar (informal)

0.01% e punëmarrësve të evidentuar ishin të aksidentuar.

Sipas degëve rajonale, kategoritë e të punësuarve evidentuar gjatë inspektimeve, rezultojnë:


Kontratat individuale të punës:

Janë 3661 punëmarrës të evidentuar të aktivitetet e inspektuara ose 1.3% e totalit të këtyre punëmarrësve, që gjatë inspektimeve të vitit 2018, janë evidentuar në punë pa kontrata pune individuale.

Të analizuara sipas llojit të aktivitetit ekonomik, nga inspektimet e kryera rezulton se në përqindje aktiviteti ku haset punësimi pa kontratë individuale është ai i bujqësisë, e ku punëmarrësit pa kontratë, zënë 14.7% të totalit të punëmarrësve të evidentuar gjatë inspektimeve në këtë sektor.

Viti 2018	Subjekte të inspektuara	Punëmarrës të evidentuar	Punëmarrës pa kontrata pune individuale	% e Punëmarrës pa kontrata pune individuale, kundrejt totalit të punëmarrësve
<i>Bujqësi, pyje ,peshkim</i>	203	1095	161	14.7%
<i>Miniera, karriera</i>	175	10582	72	0.7%
<i>Ndërmarrje prodhuese</i>	2539	108628	819	0.8%
<i>Elektricitet, gaz, ujë</i>	66	3931	85	2.2%
<i>Tregti, hotel-bar-restorante</i>	5789	46129	1678	3.6%
<i>Ndërtim</i>	1047	22970	312	1.4%
<i>Transport, telekomunikacion</i>	181	4954	64	1.3%
<i>Finance, shërbime të sigurimeve</i>	101	3072	5	0.2%
<i>Aktivitete të tjera</i>	2196	89883	465	0.5%
<i>Total</i>	12297	291244	3661	1.3%

Gjatë vitit 2018 punëmarrës të siguar mbi pagë minimale, në aktivitete private të inspektuara, 27.9% e punëmarrësve, rezultojnë 9.3 % më pak se një vit më parë. Ky tregues reflekton trendin pozitiv sa i takon deklarimit të punonjësve me pagë reale.



Të punësuar në 18 vjeç

Në bazë të inspektimeve kryer gjatë vitit 2018, rezulton se janë evidentuar 329 të punësuar nën 18 vjeç e ku 47% ishin punëmarrëse femra.

Risi e këtij viti sa i takon autorizimit që lëshon inspektori i punës për punësimin e kësaj kategorie punëmarrësish, e në kuadër të deregulimit, është mundësuar kryerja e inspektimeve me procedurë të përshpejtuar, mas kërkesave të subjekteve ekonomike që punësojnë këtë kategori punëmarrësish.

Sa i takon këtyre inspektimeve, këtë vit janë kryer 150 inspektime e ku janë autorizuar për t'u punësuar sipas kërkesave të legjislacionit të punës 295 punëmarrës të mitur.

Sipas llojit të aktivitetit ekonomik fëmijët e evidentuar në punë janë në masën 55% në aktivitetet prodhuese e në masën 27% në tregti, hotel-bar-restorante, pjesa tjetër janë evidentuar në aktivitete të tjera. Ajo ç'ka vlen të përmendim, është se në aktivitetet me rrezikshmëri të lartë, si miniera karriera, elektricitet gaz, ujë, apo në ndërtim nuk ka punëmarrës nën 18 vjeç të evidentuar në punë.

Gjatë këtij viti ISHPSHSH-ja është bërë pjesë e diskutimit dhe kanë filluar konsultimin e Planit Kombëtar të Veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge, të ngritur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijes, në vijim të procesit për konsolidimin e kuadrit ligjor të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri.

(h) SHKELJEVE TË DISPOZITAVE LIGJORE.


Nga monitori i inspektimeve realizuar gjatë Vitit 2018 kemi:

Në 89.2% të rasteve të inspektimeve me shkelje të dispozitave ligjore, vlen të përmendim se:


49% e shkeljeve, janë shkeljet e dispozitave ligjore të Kodit të Punës si dhe të VKM -ve në zbatim të tij, ndërkohë

33% janë shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit Nr. 10237 “Për Sigurinë e Shëndetin në Punë” dhe VKM -ve në zbatim të tij.

Pjesa tjetër e dispozitave ligjore të shkelura kanë të bëjnë me dispozitat e tjera të Legjislacionit të Punës ku: Nxjitja e Punësimit zë 5%, Punësimit të huajve 0.3%, Sigurimet Shoqërore e Shëndetësore 0.6%.



1. Nga dispozitat e Kodit të Punës, evidentuar në parregullsi për zbatimin e tyre rëndisim:
 - a. Kohëzgjatja e punës dhe e pushimeve në masën 30% e ku:
 - Shtesa mbi pagë në masën 29.9%
 - Puna në ditën e diel ose në ditët e festave zyrtare në masën 25%
 - Kompensimi në masën 20%
 - Pushimet vjetore/kohëzgjatja në masën 9.3%
 - Regjistri/ dhe VKM në zbatim të tij, në masën 5%.
 - b. Lindja e marrëdhënieve të punës/forma e kontratës së punës në masën 11%.
 - c. Paga/domosdoshmëria/mënyra e pagesës/përlllogaritja e pagës në masën 7%.
 - d. Përfundimi i marrëdhënieve të punës në masën 3.4%.




2. Sigurimi dhe mbrojtja e shëndetit/Kodi i Punës në masën 33%, ku vlen të përmendim:

- a) Kualifikimi i punëmarrësve. Marrja e masave mbrojtëse
- b) Masa të përgjithshme
- c) Mjetet fikëse
- d) Pajisje individuale
- e) Instruksione për punëmarrësit
- f) Instalimet sanitare

Nga shkeljet e dispozitave ligjore të ligjit Nr. 10237 “Për Sigurinë e Shëndetin në Punë” dhe VKM –ve, evidentuar gjatë inspektimeve, në zbatim të tij rëndisim:

- a. Përpilimi i dokumentit të vlerësimit dhe parandalimi të rrezikut, në masën 19%
- b. Ndihma e parë, mbrojtja kundër zjarrit dhe evakuimi i rreziqeve të rënda në masën 16%
- c. Garantimin e zbatimit të masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale në masën 11%
- d. Informimi i punëmarrësve në masën 10%.
- e. Shërbimi mjekësor i punës në masën 5%.
- f. VKM-të në zbatim të ligjit Nr. 10237 “Për Sigurinë e Shëndetin në Punë”.



Vlen të theksojmë punën e kryer nga muaji maj 2018, ku ritmi i punës në drejtim të cilësisë së inspektimit ka rezultate direkte në zbatueshmërinë e dispozitave ligjore të Legjislacionit të Punës, nga subjektet private e shtetërore.


Kështu 80% e inspektimeve të kryera gjatë vitit 2018, janë rezultat i punës intensive realizuar maj-dhjetor 2018. Eficencën e inspektimeve realizuar për periudhën maj-dhjetor 2018, e tregojnë rezultatet konkrete të këtyre inspektimeve krahasimisht me të dhënat e vitit e ku janë realizuar;

(i) Masat administrative të vendosura dhe ndjekja e tyre.

33% e masave administrative, janë "Pezullime" për shkelje flagrante të dispozitave ligjore të legjislacionit të punës

60% e masave administrative janë "Paralajmërime"

7% e masave administrative janë "Gjoha"



Në inspektimet e kryera, bazuar në procedurë inspektimi e në funksion të evidentimit të zbatueshmërisë së Legjislacionit të Punës nga punëdhënës e punëmarrës, dhe rregullueshmërive ligjore për t'u zbatuar, inspektorët e punës marrin këto masa:

- ⇒ Përmirësime në zbatueshmërinë e ligjit, me detyra konkrete për t'u realizuar, me afate kohore.
- ⇒ “Pezullim” të pjesshmë apo të të gjithë aktivitetit, për periudhë kohore deri në rregullueshmëri të shkeljes.
- ⇒ “Paralajmërim” si masë ndëshkuese për shkeljet e evidentuara.
- ⇒ “Gjobë” si masë ndëshkuese të kërkesave ligjore, parashikuar në legjislacion.

Masa ligjore “Pezullim”

Masa ligjore “pezullim”, për shkeljet flagrante të dispozitave të legjislacionit të punës është aplikuar në 855 inspektime, nga të cilat 844 ose 98.7% e tyre janë për rregullueshmëritë e shkeljeve ligjore evidentuar gjatë inspektimeve, për marrëdhënie punë jo korrekte dhe 11 janë për rregullueshmëritë e shkeljeve ligjore evidentuar gjatë inspektimeve për siguri dhe shëndet në punë.


Kjo masë ligjore është aplikuar më së shumti në degën rajonale Tiranë, Vlorë, Dibër, Kukës, Shkodër e Korçë në mbi 9% të inspektimeve realizuar në këtë periudhë nga këto degë rajonale.

Masa administrative “Pezullim” është mbajtur kryesisht në inspektimet me punëmarrës informal të evidentuar.

Ndërkohë sipas llojit të aktivitetit ekonomik rezulton se kjo masë është aplikuar më së shumti në numër në Tregëti, hotel-bar-restorante.

Lloj aktiviteti	Inspektime	Raste inspektimesh me mase "Pezullim"	Inspektime me pezullim në % kundrejt totalit të inspektimeve për lloj aktiviteti
Bujqësi, pyje, peshkim	203	35	17.7%
Miniera karriera	175	24	13.7%
Ndërmarrje Prodhuese	2539	138	5.4%
Elektricitet, gaz, ujë	66	0	0.0%
Tregti, hotel-bar-restorante	5789	443	7.7%
Ndërtim	1047	67	6.4%
Transport, magazinim, telekomunikacion	181	11	6.1%
Finance, shërbime të sigurimeve	101	6	5.9%
Aktivitete të tjera	2196	131	6.0%
Total	12297	855	7.0%

Por e parë në % me numrin total të inspektimeve sipas llojit të aktiviteti kjo masë administrative rezulton:




Masa administrative “Paralajmërim”

Masa administrative “Paralajmërim”, për shkeljet e dispozitave të legjislacionit të punës është masa që praktikohet më shumë në inspektimet e realizuara. Kështu, në 12297 inspektime të kryera në këtë periudhë, në 1538 inspektime është aplikuar kjo masë.

Krahasimisht me numrin e inspektimeve nga çdo degë rajonale, kjo masë ligjore është aplikuar në 71% të totalit të inspektimeve të realizuara nga dega Berat, në 40% të totalit të inspektimeve të realizuara nga dega Vlorë.

Ndëkohë sipas llojit të aktivitetit ekonomik rezulton se kjo masë është aplikuar në 39.4% të totalit të inspektimeve realizuar në miniera kariera, inspektuar në këtë periudhë, në 33%, të rasteve të inspektimeve në aktivitetin elektrikitet gaz ujë.

	Inspektime	Raste inspektimesh me mase "Paralajmërim"	Inspektime me paralajmërim në % kundrejt totalit të inspektimeve për lloj aktiviteti
Bujqësi, pyje, peshkim	203	39	19.2%
Miniera kariera	175	69	39.4%
Ndërmarrje Prodhuese	2539	378	14.9%
Elektricitet, gaz, ujë	66	22	33.3%
Tregti, hotel-bar-restorante	5789	630	10.9%
Ndërtim	1047	172	16.4%
Transport, magazinim, telekomunikacion	181	20	11.0%
Finance, shërbime të sigurimeve	101	4	4.0%
Aktivitete të tjera	2196	204	9.3%
Total	12297	1538	12.5%



Masa administrative “Gjobë”

Masa administrative “Gjobë”, për shkeljet e dispozitave të legjislacionit të punës është aplikuar në 175 inspektime të kryera.



Krahasimisht me numrin e inspektimeve nga çdo degë rajonale, kjo masë ligjore është aplikuar në 1.4% të totalit të inspektimeve të realizuara nga 12 degët rajonale.

Në krahasim me një vit më parë kemi një dyfishim të subjeteve të sanksionuara.

Lloj aktiviteti	Inspektime	Raste inspektimesh me mase "Gjobë" 2018	Vlere gjobe (.000)	Inspektime me gjobe në % kundrejt totalit të inspektimeve për lloj aktiviteti	Vlere mesatare e gjobes (.000)/2018	Vlere mesatare e gjobes (.000)/2017
Bujqësi, pyje, peshkim	203	0	0	0.0%	0	0
Miniera karriera	175	16	2532	9.1%	158	340
Ndërmarrje Prodhuese	2539	49	13260	1.9%	271	206
Elektricitet, gaz, ujë	66	2	500	3.0%	250	230
Tregti, hotel-bar-restorante	5789	47	4598	0.8%	98	130
Ndërtim	1047	17	3216	1.6%	189	163
Transport, magazinim, telekomunikacion	181	2	148	1.1%	74	100
Finance, shërbime të sigurimeve	101	1	100	1.0%	100	190
Aktivitete të tjera	2196	41	5500	1.9%	134	152
Total	12297	175	29854	1.4%	171	172

Sipas llogaritjes së një mesatareje për lloj aktiviteti, vlerë mesatare e gjobave, rezulton më e madhe e aplikuar ne aktivitet prodhuese, elektricitet gaz ujë, ndërtim e në miniera karriera, aktivitete këto me rrezishmëri të lartë për sigurinë e shëndetin në punë.

Vlera mesatare e gjobës është krahasimisht me një vit më parë është po ajo, por duke e krahasuar këtë tregues për lloj aktiviteti vëmë re se në vitin 2017 aktivitetet minerare janë ato me vlerë mesatare gjobe 2 fishi i asaj mesatare.



Gjatë këtij viti janë ankimuar 48 vendime me gjobë ose 27% e gjobave të aplikuara, nga të cilat Komisioni i Ankimit të Vendime Përfundimtare, ka lënë në fuqi 43 prej tyre ose 89%, dhe pjesa tjetër janë shfuqizuar.

Nga vlera 29 854 000 e sanksioneve të vendosura në 175 subjekteve për këtë vit, na rezultojnë të arkëtuara vlera e 12 963 958 lekë .


Treguesit e inspektimeve në Fushën e Shërbimeve Shoqërore

Bazuar në bazën e të dhënave që DISSHSH disponon, informacioni i së cilës, përditësohet nga inspektimet e kryera, evidentohen të ofrojnë shërbime të përkujdesit shoqëror një numër prej 296 subjekte publike dhe jopublike, (92 shërbime rezidenciale, 91 qendra ditore, 8 qendra multidisciplinare dhe 105 shërbime komunitare).

Për periudhën Janar – Dhjetor 2018 në total janë inspektuar 129 qendra publike dhe jopublike të cilat ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror.

Përgjatë vitit 2018, DISSHSH i është përmbajtur inspektimit të planifikuar. Kështu, janë ushtruar 116 inspektime të planifikuara dhe 13 inspektime të paplanifikuara, nga të cilat 2 për trajtim ankese dhe 11 për janë inspektime për vlerësim standartesh për efekt të zbatimit të procedurave të licensimit. Inspektimet për vlerësim standartesh për efekt të licensimit bazohen në kërkesat e ardhura nga MSHMS.

Inspektime gjithsej të realizuara	129
Inspektime të planifikuara	116
Inspektime të paplanifikuara	13



Në analizën vjetore, të vitit 2017, është konkluduar me tre problematika kryesore të drejtorisë, siç është:

- Ligjore: vonesa në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.121/2016 datë 24.11.2016;
- Burime njerëzore të kufizuara;
- Mungesë logjistike;

Pavarësisht se vazhdon mosmiratimi i akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” dhe me të njëjtat burime njerëzore, DISSHSH, **vetëm në sajë të mbështetjes logjistike, arriti në vitin 2018 të realizojë 55 inspektime më shumë se një vit më parë.**




DISSHSH, në drejtim të realizimit të detyrës funksionale, inspektimit të qendrave të përkujdesit shoqëror, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit, rritjen e sigurisë dhe të mbrojtjes së përfituesve, forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimit dhe forcimin e vetë komuniteteve, përcaktoi si prioritet për vitin 2018 inspektimin e qendrave të kujdesit rezidencial dhe qendrave të kujdesit komunitar.

Në përputhje me këtë, **për vitin 2018 u inspektuan:**

- 69 qendra të kujdesit komunitar e ditor, nga të cilat 7 qendra publike;
- 45 qendra të kujdesit rezidencial, nga të cilat 17 qendra publike;
- 4 qendra të kujdesit multidisiplinar, nga të cilat 1 publike.

Në mënyrë grafike, përkujdrejt inspektimeve gjithësej inspektimet sipas tipologjive të shërbimit janë si më poshtë:



Përsa i takon numrit të përfituesve në qendrat e shërbimeve të përkujdesit shoqëror të inspektuara të dhënat janë si më poshtë:

Shërbime të kujdesit rezidencial:	1167 (fëmijë, PAK, të moshuar, viktimat të dhunës në familje, familje në situatë emergjence, etj);
Shërbime të kujdesit komunitarë:	4109 (fëmijë, PAK, të moshuar, viktimat të dhunës në familje, individë apo familje në situatë emergjence, etj);

Përsa i takon shpërndarjes gjeografike të inspektimeve, është mbuluar pothuajse i gjithë territori i vendit, por më veçanërisht u inspektuan qarqet dhe bashkitë periferike, me numër relativisht të lartë shërbimesh, sikurse janë Korça, Erseka, Gjirokastra, Saranda, Shkoda, Fush-Arrëz, Berati, Çorrovoda, etj.

Inspektimi i Standarteve, zhvillimet pozitive dhe gjetjet nga inspektimet e kryera.

Në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimit të ofruar duke ndjekur një proces plotësimi të kriterëve të standarteve të shërbimit sipas tipologjisë së tij apo standarteve të përgjithshme të aplikuar në mungesë të standarteve të rrjedhura nga Ligji i Ri Nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, nga inspektimet e realizuara gjatë vitit 2018, konstatohen arritjet si më poshtë:

Si një tregues mjaft i rëndësishëm i cilësisë së shërbimit është zbatuar përgjithësisht përmirësimi i strukturave të stafeve të shërbimit me figura profesionale dhe përputhja e tyre me vendin e punës. Është rritur struktura e shërbimit me figura teknike sidomos në tek qendrat jopublike që ofrojnë shërbime të specializuara për Personat me Aftësi Ndryshe.

Gjatë inspektimeve të bëra në 2018 rezulton përgjithësisht të jenë realizuar rekomandimet e dhëna në inspektimet e mëparëshme për qendrat publike të përkujdesit rezidencial lidhur me ndërhyrjen në infrastukturë për përmirësimin e gjendjes fizike të godinave. Konstatohet ndërhyrje e qenësishme me shumë impakt në komoditetin dhe cilësinë e jetës së përfituesve në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, Shtëpinë e të Moshuarve Fier, në Qendrën Ditore të Zhvillimit Lezhë, etj.

Një vëmendje të veçantë, gjatë inspektimeve të vitit 2018, i është kushtuar edhe aksesueshmërisë së shërbimit për personat e pamundur për të lëvizuar. Nga inspektimet rezultoi që përgjithësisht, qendra jopublike janë të aksesueshme, pa barrierë fizike të jashtme, si edhe konstatohen modele shumë të mira aksesueshmësie në ambjentete të brendshme.

Ndryshe ndodh me qendrat publike të përkujdesit, veçanërisht me qendrat e përkujdesit për persona me Aftësi të Kufizuar, si edhe deri diku për qendrat rezidenciale për të moshuarit. Qendrat rezidenciale të ndërtuara hershëm, nuk janë komode, me elementë të aksesueshëm për shërbimin ndaj këtyre personave. Qëndrimi i DISSSH ka qenë dhe do të mbetet rekomandimi ndaj bashkive përkatëse për ndërhyrje të qenësishme deri në gjetjen e godinave të reja, funksionale.

Gjatë inspektimeve të bëra në 2018 rezulton i realizuar rekomandimi i dhënë në inspektimet e mëparëshme në drejtim të respektimit të procedurave të Ankimimit, si një çështje dhe praktikë e rëndësishme e standarteve të shërbimeve shoqërore, si masë paraprake në luftën kundër abuzimit me përfituesin e shërbimit. Është konstatuar, përgjithësisht, në të gjitha qendrat e shërbimit, publike dhe jopublike, pavarësisht tipologjisë së shërbimit, ai është i aplikueshëm dhe proces që kryhet me seriozitet duke sensibilizuar familjarët si dhe gjithë komunitetin.

Pas rekomandimeve të dhëna për qendrat publike, për SHSSH dhe Bashkinë përkatëse, lidhur me instalimin e sistemeve të alarmit në godina, me qëllim rritjen e sigurisë fizike të përfituesve, nga inspektimet e bëra përgjatë vitit 2018, është konstatuar që në të gjitha qendrat publike rezidenciale për të moshuarit janë instaluar sisteme alarmi, si në ambjentet e përbashkëta, po ashtu edhe në dhomat e akomodimit të moshuarve. Gjithashtu, po në drejtim të rritjes së sigurisë së përfituesve, konstatohet si një zhvillim pozitiv vendosja e kamerave të sigurisë.

Janë plotësuar rekomandimet, rast pas rasti, për plotësimin e dosjeve të përfituesve dhe kryerjen periodike të vlerësimeve të nevojave dhe Planit Individual.

Janë plotësuar rekomandimet, rast pas rasti, për zbatimin e procedurave të pranimit në institucion. Përgjithësisht, në institucionet rezidenciale për fëmijë rezultojnë raste të fëmijëve pa vendimin e komisionit përkatës, marrjen në kujdestari etj, por nënvizohet, që në pak raste është konstatuar i njëjti fëmijë në dy inspekte. Këto raste janë evidentuar si raste, për të cilat është dashur bashkëpunimi i disa strukturave, aktorëve e në qytete të largëta me qendrën e shërbimit, (polici, gjendje civile, NjMF, administrator social i Njesisë Administrative), dhe si detyrë kanë kërkuar më shumë kohë, ndaj nuk janë propozuar masa administrative, por janë vlerësuar si detyra në ndjekje.

Janë zbatuar nga të gjithë institucionet, rekomandimi për plotësimin e dosjeve të stafit, së pari dhe plotësisht është plotësuar me Dëshmi Penaliteti të punonjësit, me vlerësim të performancës së punonjësit, por edhe për dokumente të veçanta sipas konstatimeve konkrete. Por mbetet për t'u bërë ende për administrimin të prezencës në institucion të një kopje të njësuar të dosjes së personelit, kur punëdhënësi është bashkia.

Është rekomanduar hapja e qendrave publike ndaj studentëve praktikantë apo vullnetarëve, me qëllim sjelljen e qasjeve të reja, përkundrejt stërvitjeve apo lodhjeve nga koha e gjatë në shërbim, veçanërisht e kujdestarëve. Përgjithësisht, është konstatuar se studentë të degëve të punës sociale, psikologji e mësuesi, kryejnë praktikat mësimore në qendrat publike të kujdesit shoqëror për fëmijë në Korçë, në qendrat e përkujdesit në Shkodër, si edhe në Tiranë, etj.

Gjetjet nga kontrollet e ushtruara, përgjatë vitit 2018 janë si më poshtë:

Liçensimi në QKL të qendrave publike për ofrimin e shërbimit të kujdesit në nënkategorinë shërbime të kujdesit rezidencial. Më së shumti, rezulton që institucionet publike kanë ngecur në përfundimin e kësaj detyre në sigurimin e dokumentit të pronësisë, siguri i së cilës apo rregullimi ligjor i saj është e mundur vetëm nga institucioni i bashkisë. (Bashkia Shkodër, Bashkia Vlorë, Bashkia Sarandë, Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Poliçan, etj). Për mosrealizimin e kësaj detyre është paralajmëruar për masa administrative.

Riorganizimi apo rimodelimi i shërbimit në përputhje me nevojat e përfituesve në qendrat publike. Nga ana e DISSHSH është rekomanduar që të gjitha qendrat rezidenciale për PAK, në bashkëpunim me Bashkinë, duke tërhequr ekspertë të fushës, të rimodelojnë shërbimin në përputhje me, historikun, nevojat dhe potencialet rikuperuese të secilit prej personave me AK. Një alternative konkrete mund të jetë ndarja e shërbimeve rezidenciale për Pak në nën kategori, ku për PAK me sëmundje të rënda mendore terminale të formohet shërbimi hospitalizues, kryesisht për moshat mbi 25 vjeç, që përgjithësisht zënë 80% të këtyre qendrave rezidenciale, përfshirë brenda tyre edhe PAK të braktisur që nuk kanë strehë familjare.

E njëjta gjë, pra rimodelimi i qasjes ndaj nevojave të përfituesve, është kërkuar edhe për Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës, e cila duhet të ofrojë edhe mundësi kujdesi ditor për fëmijët e familjeve të strehuara në këtë qendër.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive në drejtim të plotësimit të stafit me figura profesionistësh, mbetet problematike rishikimi i strukturës dhe plotësimi i saj me figura si punonjës social, psikolog, mjek specialist psikiatër/neuropsikiatër, terapistë të specialiteteve logopedist, fizioterapist, si edhe shtimi i numrit të kujdestarëve.

Zhvillime pozitive dhe domethënës, në këtë drejtim, konstatohen, përgjithësisht, në qendrat jopublike të kujdesit shoqëror. Në qendrat jopublike, rezidenciale apo ditore, pavarësisht përpjekjeve të bëra, mungesa e figurës së profesionistit justifikohet nga ofruesi i shërbimit me mungesën e kësaj figure në tregun e punës, ku tipike është rasti në Ersekë, Burrel, etj. Në qendra shërbimesh në zona urbane, me më shumë popullsi dhe akses në universitete, nga ana e DISSSH, është urdhëruar dhe me afate të shkurtra, plotësimi i stafit me figurën e munguar.

Përgjithësisht, nevoja e plotësimit të stafit konstatohet në qendrat publike rezidenciale, dhe më së shumti, në qendrat rezidenciale të zhvillimit. Shqetësim mbetet fakti se strukturat e këtyre qendrave të shërbimit janë përgjegjësi e Bashkive, të cilat vazhdojnë të ruajnë strukturat e qendrave të miratuara me VKM, që nga koha kur këto qendra ishin në administrim të SHSSH, dhe me transferimin në varësi të bashkive, rezultojnë të jenë bërë modifikime minimaliste, ndryshim titullari të qendrës apo shtim të një numri shumë të kufizuar punonjësish, përgjithësisht kujdestar e sanitar.

Sikurse u parashtrua edhe më lart, tre problematikat kryesore të ndeshura, edhe gjatë vitit 2018, janë të lidhura me përgjegjësinë e pushtetit lokal, cili me ligjin e ri është autoriteti përgjegjës për ofrimin dhe garantimin e shërbimeve për komunitetet në nevojë në territorin e tyre administrativ.

Për gjatë vitit 2017 dhe 2018 janë ngritur shërbime të reja, të tipologjisë së shërbimit komunitar multidisiplinar me bazë familje, kryesisht në bashki të mëdha të vendit. Këto qendra deri në Dhjetor 2018, kohë kur u miratuan Standartet e Shërbimeve Të Kujdesit Shoqëror në Qendrat Komunitare Shumëdisiplinore, janë krijuar si projekte pilot, pa referime e standarte të qarta. Ngritja e një modeli të tillë i shërben ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në mënyrë uniforme, në zbatim të dispozitave specifike të ligjit nr. 121/2016, por duke respektuar edhe kuadrin ligjor që lidhet me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, rëndësinë e këtyre shërbimeve komunitare për të përmbushur nevojat e anëtarëve të komunitetit, me karakteristika të veçanta, është natyrshëm prioriteti i programit të punës së DISSSH për vitin 2019.

Sektori i Burimeve Njerëzore ka ndjekur procedurat e rekrutimeve me DAP, pasi marrëdhëniet e punësimit të ISHPSHSH-së rregullohen me ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, pasi gjatë 2018 ka patur vende vakante si për pozicion Kryeinspektori Rajonal për Degët Elbasan, Berat, Gjirokastrë dhe Lezhë ashtu dhe për rolin inspektor pune 14 në degët Kukës, Fier, Berat, Lezhë, Dibër, Elbasan Gjirokastrë, Tiranë, Shkodër dhe Korçë.

Në 6-mujorin e dytë të 2018 ka patur një bashkëpunim shumë të mirë me DAP duke bërë që të plotësohen një pjesë e mirë e vakancave duke zbatuar të gjithë procedurat e parashikuara nga ligji.

Burimet njerëzore

Në muajin Dhjetor 2018 është bërë e mundur edhe shpallja e 7 vendeve vakante, 3 të paplotësuara nga procedurat e mëparshme, inspektorë në Berat, Kukës dhe Vlorë dhe 4 vende vakante, inspektorë, të krijuara nga dorëheqje dhe dalje në pension të cilat janë në procedurë.

Gjatë vitit 2018 janë marrë disa masa disiplinore për mangësi në punë:

- ⇒ Larguar me masë disiplinore 3 nënpunës mbështetës në nivel qendror.
- ⇒ Masë disiplinore “Vërejtje” nga eprori direkt, në 7 raste për inspektorë pune

Kanë marrë masa nga Komisioni disiplinor :

- ⇒ “Largim nga Shërbimi Civil” për një Kryeinspektor Rajonal
- ⇒ "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 1 vjeçare" për 1 drejtor drejtorie në nivel qendror,
- ⇒ "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 3 mujore" për 2 përgjegjës sektori, në nivel qendror,
- ⇒ "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 6 mujore”, për 6 inspektorë pune në nivel rajonal,
- ⇒ "Heqjen e 1/3 të pagës për 3 muaj" për 2 inspektorë në nivel rajonal.
- ⇒ "Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen e shkallës e pagës për një periudhë 2 vjeçare" për 4 inspektorë në nivel rajonal.

Buxheti

Instrumenti financiar për zbatimin e politikave dhe objektivave të institucionit është buxheti i shtetit. Në tabelën e mëposhtme jepet buxheti sipas zërave, në lekë për 2018 dhe ai 2019.

Nr	Emërtimi	2018	2019
1	Paga	116.700.000	126.800.000
2	Sigurime shoqërore e shëndetsore	21.140.000	22.340.000
3	Mallra e shërbime	38.000.000	34.328.000
4	Investime	10.000.000	10.000.000
	TOTALI	185.840.000	193.468.000

Janë planifikuar dhe realizuar shpenzimet prioritare për karburant, rimbursim me dieta për lëvizje të personelit, kanceleri etj. U akorduan 10 milion fonde për blerje automjete.

Edhe për vitin 2019 fondi për investime është në vlerën e 10 milion lekëve, ndërkohë që buxheti për këtë vit rezulton 4% më i lartë se një vit më parë.

VIII. DISA NGA PROBLEMATIKAT KRYESORE, HASURA GJATË PUNËS

Problematikën kryesore ISHPSH-ja e ka në lidhje me strukturën e institucionit. Kjo si në aspektin organizativ të përcaktuar ashtu dhe në atë numerik të nënpunësve. Aspekti organizativ i saj ka difekte të cilat nuk lejojnë një harmonizim në funksionim të saj, duke qënë se ka problematika struktura organizative rajonale dhe qendrore. Kështu: Degëve Rajonale të ISHPSHSH-së u duhet të administrojnë një buxhet të caktuar, ndërkohë që sipas strukturës kjo e fundit është e përbërë vetëm nga Kryeinspektor rajonal dhe inspektorë pune. Në degët rajonale Fier, Gjirokastrë, Korçë, Dibrë, Vlorë, Durrës dhe Elbasan është caktuar një inspektor të mbulojë dhe çështjet financiare të degës duke cënuar procesin e inspektimit. Ndërkohë që degët Shkodër, Lezhë, Berat dhe Kukës po administrohen nga Sektori i Financës pranë Drejtorisë Qendrore.

Edhe pse ligji, na ngarkon të inspektojmë të gjithë aktivitetet ekonomike në RSH, me këtë numër inspektorësh që ka aktualisht ISHPSHSH-ja, mbulohen me inspektim rreth 5 % e subjekteve aktive të regjistruara në QKB. Shpërndarja e inspektorëve të punës në shtrirje gjeografike ka nevojë për ndërhyrje. Në vëmendje sjellim, Degën Kukës me shtrirje gjeografike në rrethet Tropojë, Kukës e Has dhe që mbulohet nga dy inspektor gjithsej, ndërkohë që në qarqet Dibrë, Korçë, Gjirokastrë, Lezhë, zona të caktuara mbeten jashtë mbikqyrjes së inspektoratit për shkak të numrit të vogël të inspektorëve të punës dhe një shtrirje gjeografike e konsiderueshme brenda qarkut. Ka nevojë për mbështetje logjistike për kryerjen e inspektimeve edhe në zona të thella, ku zhvillojnë aktivitete ekonomike aktivitete që klasifikon me risk të lartë sa I takon sigurisë në punë, përmëdim këtu Hec, minierat etj.

Kryerja e inspektimit online, ku një grup inspektimi duhet të punojë me një paisje portabël, vështirëson dhe ngadalëson procesin inspektues, prandaj është e nevojshme mbështetje logjistike për kryerjen e inspektimeve në të gjithë territorin e Republikës.

Duke qënë se tashmë ISHPSHSH-ja të gjithë procesin e inspektimit e kryen online dhe flasim për një institucion të informatizuar, pozicioni i shkurtuar në strukture të IT-së, dhe atashim të tij tek AKSHI, ka sjellë probleme në punën e përditshme, pasi për shkak të specifikës që kemi ku rol duhet të ketë dhe njohuri specifike të fushës, për të gjetur zgjidhje më të shpejta. Theksojmë se dhe vetë inspektorët kanë vështirësi në artikullimin e raportimit të problemeve, që hasin gjatë punës në sistemin “e-inspektimi”.

Edhe vetë struktura e Drejtorisë Qendrore ka të domosdoshme një ristrukturim të shpejtë për shkak se mënyra se si është aktualisht, nuk siguron monitorim harmonik të punës inspektuese të terrenit, duke copëzuar procesin inspektues në çështje që përfshijnë marrëdhënie pune dhe siguri dhe shëndet në punë, që në fakt janë pjesë e një procesi të vetëm inspektimi.

Ende nuk e kemi të mundur aksesin e deklarimeve të subjekteve për punëmarrës, që fillojnë punën për herë të parë apo rishtaz dhe që largohen nga skema “E-Sig 027”. Mungesa e këtij oportuniteti për inspektorët e punës do të thotë kohëzgjatje procesi inspektues për të konkluduar nëse punëmarrësit, të cilët po verifikojnë janë apo jo informalë dhe rrjedhimisht marrja e një mase urgjente të pezullimit të punës bëhet me vonësë. Pavarësisht se nga ana jonë, si institucion janë ndërmarrë të gjithë hapat e duhur duke e bërë këtë çështje tryeze të përbashkët me institucionet përgjegjëse DPT, IQ dhe AKSHI ende nuk ka marrë zgjidhje.

Portalin “e-inspektimi”, në raport me mosmundësimin e raporteve statistikore me të dhëna që plotësohen gjatë procesit të inspektimit. Aktualisht të dhënat e raportuara meren bazuar në raporte individuale të hedhura manualisht për punë të kryer, duke zënë një pjesë jo të vogël të ngarkesës së punës në të gjithë rolet (Inspektor rajonal, Kryeinspektor Rajonal, Inspektor në nivel qendror), çdo fillim muaji dhe duke mbajtur në vete një nivel të caktuar saktësie. Pavarësisht se kërkesat tona e kanë identifikuar shumë qartë këtë fakt dhe janë adresuar si pranë IQ ashtu dhe Kompanisë zhvilluese, ende nuk është bërë e mundur zhvillimi i raporteve për të dhëna që përfshijnë treguesit specifikë të inspektimit të punës.

Në vitin 2016, u miratua ligji , nr.121/2016 datë 24.11.2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka përcaktuar forcimin e kapaciteteve kontrolluese të aktorëve që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror. Ky ligj e përcakton Inspektoriatin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, si personi juridik publik buxhetor, pra një strukturë më vete në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet sociale. Ky ligj, qartazi ka zgjeruar tipologjitë e shërbimeve, ka rritur aktorët që ofrojnë shërbime, ku në rradhë të parë është pushteti vendor pasi përmes tij u janë deleguar kompetencë dhe përgjegjësi, për të krijuar e administruar shërbime të kujdesit shoqëror për të gjithë kategoritë në nevojë, banorë në territorin e tyre.

Paketa e akteve nënligjore, si për forcimin e strukturës përgjegjëse për inspektimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, po ashtu, për miratimin e lidhur me përgjegjësitë e bashkive, procedurat dhe standarteve e reja të shërbimeve të kujdesit shoqëror, nuk është miratuar ende duke bërë që kjo strukturë pavarësisht konstatimeve dhe rekomandimeve të saj të mos përmbushë plotësisht qëllimin për të cilin është krijuar që do të thotë mekanizmi i kontrollit dhe vendimamarrës për kategorinë e qendrave që nuk zbatojnë standartet.

IX. KONKLUZIONE E REKOMANDIME NGA TË DHËNAT E INSPEKTIMEVE

Struktura e ISHPSHSH-së aktualisht, nuk përballon ngarkesën e punës që i duhet të kryejë, si aspektin cilësor ashtu dhe në atë sasior. Ka nevojë imediate për ndërhyrje në planin organizativ për të siguruar funksionalitetin normal të punës, për të mos patur ulje të efikasitetit të institucionit. Gjithashtu ka nevojë të shtuar për mbështetje logjistike në funksion të mabrëvjatje të procesit të punës së institucionit.

Duke qënë se inspektimet e realizuara jashtë programimi, sipas analizës së treguesve të inspektimit të punës reflektojnë efektivitetin në inspektim, kërkojnë një vëmendje të shtuar për rivlerësim të çështjeve të planifikimit të inspektimit, drejt inspektimeve që kanë risk të lartë për informalitet në të gjithë format e shfaqjes së tij.

Problematikat që reflektojnë inspektimet rastësore, e kryera në ditët e pushimit javor, festave zyrtare apo punës në turne, tregojnë qartë, mangësi në efektivitetin e planifikimit të inspektimeve rutinore, cilësi e dobët inspektuese dhe organizimi joefiçent në ndarjen e zonave gjeografike inspektuese.

Gjithashtu çështjet e mosdeklarimit të pagës reale të dakortësuar mes palëve (punëdhënës – punëmarrës) si dhe për mospërlllogaritja e kësaj të fundit mbi punë të kryer në ditët e pushimit javor, festave zyrtare, punë e kryer në turne e në orë shtesë, janë çështje të cilat mbartin informalitetin gri dhe të cilat prodhojnë një numër të konsiderueshëm ankesash e mosmarrveshje mes palësh. Këto fenomene pavarësisht faktit se janë pjesë përbërëse në të gjithë analizën e mësipërme, vijnë të mbeten të pazhvilluara në raportim cilësor treguesish duke krijuar bazë të dhënash me qëllim gjetjen e mekanizmave të duhur dhe efikas për përmirësim.

Nga analiza e aksidenteve në punë të njoftuara dhe të trajtuara nga inspektorët e punës, rezulton se numrin më të madh të tyre e ka Dega Rajonale e ISHPSHSH-së Dibër. Pavarësisht faktit se numri i madh i aksidenteve, është në subjektet me aktivitet minerar dhe për shkak të riskut të lartë që paraqet ky aktivitet ka dhe ligj specifik rregullues, kërkon një rivlerësim të të gjithë Degës Rajonale Dibër sa i takon kapaciteteve dhe logjistikës së saj.

Përsëritja e aksidenteve në të njëjtin subjekt është një tregues, që reflekton dhe përmbledh një sërë elementesh që lidhen me cilësinë dhe efektivitetin e inspektimeve të kryera në këto subjekte, mungesën e monitorimit të vazhdueshëm të kësaj kategorie subjektesh dhe nevojën për rishikim të elementeve të riskut për planifikim inspektimesh.

Në të gjithë analizën e mësipërme, roli i bashkëpunimit ndërinstitucional me agjensitë e tjera ligjzbatuese tregon se ka një peshë jo të vogël në drejtim të efektivitetit të inspektimit sidomos

ajo e një bashkëpunimi funksional dhe sistematik me DPT, si në nivel qendror ashtu dhe rajonal, për të dhënë zgjidhje në kohë reale problemeve të informalitetit. Në këtë kontekst kërkohet dhe mbështetje nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Edhe me agjensitë e tjera është shumë e nevojshme rritja e bashkëpunimit duke e ngritur në nivel profesional-zbatues.

Ajo që duhet theksuar është nevoja për monitorim të vazhdueshëm të Degëve Rajonale sin ë aspektin e planifikimit ashtu dhe në atë të procesit inspektues. Ky monitorim duke u bërë përmes platformës tashmë të vënë në punë të “Matricës së dënimeve”, mer vlerë të shtuar në lidhje me performancën e inspektimit në tregun e punës. Ky monitormi të konsistojë në ndjekjen e detyrave të lëna për zbatim nga inspektorët, dhënien prioritet sipas rëndësisë çështjeve të caktuara që reflektojnë treguesit e punës.

Rekomandime

Degët Rajonale të kryejnë një rivlerësim sa i takon ndarjes territoriale në qark, për mbulim me inspektim duke u bazuar në një hartë të përcaktuar qartë shpërndarjen e aktiviteteve me risk, me qëllim rritjen e produktivitetit në inspektim.

Monitorimi i vazhdueshëm i procesit duke identifikuar problematikat hap pas hapi, si dhe duke bërë një rivlerësim të treguesve të vlerësimit për çdo punonjës të ISHPSHSH-së

Rritja e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe koordinimin procedurash, nën mbikqyrje të Autoriteteve Politikbërës.

Proçese trajnimi të vazhdueshme për trupën inspektuese me qëllim rritjen profesionale të këtyre të fundit.

IX. OBJEKTIVAT PËR VITIN PASARDHËS.

- ⇒ Forcimi i sistemit të inspektimit të punës
- ⇒ Orientimi dhe forcimi i kontrolleve në sektorët problematikë në raport me punësimin informal
- ⇒ Orientimi dhe forcimi i kontrolleve këshilluese dhe në sektorët me risk të lartë për aksident në punë dhe sëmundje profesionale
- ⇒ Përdorimi i masave efikase për të patur më shumë vende pune të sigurta dhe të shëndetshme
- ⇒ Më shumë punëmarrës dhe punëdhënës të informuar dhe këshilluar për të drejtat dhe detyrimet që ju burojnë nga legjislacioni i punës.
- ⇒ Njohja dhe respektimi i standarteve të shërbimeve, rritja e kujdesit, por edhe rritja e kapaciteteve të pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve komunitare, në përputhje me nevojat e gjithë komunitetit, nëpërmjet inspektimit të qendrave të krijuara nga bashkitë në kuadër të rolit dhe të përgjegjësisë të marra nga bashkitë me Ligjin e Ri Nr.121/
- ⇒ Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror, garantimi i respektimit të standarteve të shërbimeve, më qëllim respektimin e të drejtave të përfituesit dhe mbrojtjen e tij nga diskriminimi, dhuna, abuzimi, duke vlerësuar prioritet forcimin e mekanizmave, procedurave të mbrojtjes si edhe rritjen e sensibilitetit të komunitetit ndaj procesit të ankimimit.